



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:152184

Datë: 24.07.2024

Numri i dokumentit: 05973022

P.nr.449/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit H.S nga fsh. P K .S për shkak se ka kryer veprë penale „Asgjësim apo dëmtim i pasurisë ” nga neni 321 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1240/21 të datës 08.07.2021, në bazë të nenit 229 par.5, 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë shqyrtimit, me datë 21.06.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim me shenjë ND.nr.826/2024, e lidhur me datë 22.05.2024 në mes të pandehurës H.S nga fsh. P K .S me nr. personal dhe palës së dëmtuar A.B përfaqësues i Kompanisë „.....” me nr. personal
- II. HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1240/2021 të datës 08.07.2021
- III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit H.S nga fsh. P K .S , për veprë penale „Asgjësim apo dëmtim i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPRK-së, për shkak se e pandehura në njërin anë dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar kanë arritur marrëveshje me ndërmjetësim.
- IV.** Shpenzimet e procedurës penale i bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.1240/2021 me datë 08.07.2021, ndaj të pandehurit, H.S nga fsh. P K .S për shkak se ka kryer vepër penale „Asgjësimit apo dëmtim i pasurisë ” nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me datë 22.05.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë, me kërkesën e të pandehurve që kjo çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit gjykata lidhur me këtë propozim morri pëlqimin palës së dëmtuar, Prokurorit të Shtetit, me ç ‘rast palët janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes eventuale.

Pas pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtarja e çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 22.05.2024, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate në mënyrë që ta procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datë 22.05.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi Haxhi Ibërdemaj, në mes të pandehurit H.S dhe palës së dëmtuar „.....” A. B në anën tjetër.

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarës palët kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush njëkohësisht të pandehurit i shpreh keqardhje i kërkuan falje të dëmtuarit me ç ‘rast i dëmtuari e pranojnë kërkim faljen nga të pandehurit dhe nuk kërkon kurrfarë kompensimi.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 22.05.2024, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.nr.826/24 ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPPRK-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve dhe është në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, ku kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5, 357 par.1 nën par. 1.3, nenit 453 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Departamenti i Përgjithshëm,

Divizioni Penal

P.nr.449/2021, me datë 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Gylaj Nepola

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimt të këtij aktvendimi, pranë Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.